



KOMUNA KLINE
ZYRA E PROKURIMIT
01/351-29524/24
30.08.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 te hyre ne fuqi 01.12.2011, mbi Aktivitetet e Menagjimit te kontrates, Menagjeri i Zyres se prokurimit , bie kete :

V E N D I M

Qe per Menagjimin e kontratës bazë nr. 76-2024 e datës 30.08.2024
Me titull “ **Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portës më dedikim në hyrje te objektit të QPS-së ” Më O.E „TINI” Medvegjë.** Me nr: Te prokurimit: **634-24-7640-1-2-1-** vlera e kontratës: **21.341.50 €**; per menagjim te kontrates do te jete: **LUAN QERKINAJ** si bartes i aktiviteve , dhe implementues i projektit Nga **D.E ADMINISTRATËS BINAK SYLAJ** afati kohor për dorzim 30 ditë

Menagjeri i projektit ,njeherit edhe pergjegjes per menagjimin e kontrates , do te formoj komisionin per percjellje dhe komisionin per pranim.

Kryesyesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithesecilen faze te aktiviteve zyren e prokurimit , dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontrates.

Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit sebashku me kontrate , oferten financiare.

Vendimit i bashkangjiten : kontrata , paramasa , plani dinamik , plani i mengjanimit te kontrates .

ZKA - KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

01 Nr. 351-29524/24

Date 08.30.08.2024

KONTRATË NR. 76-2024

Numri i kontratës ¹: 634-24-7640-1-2-1/C788

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë: dhe

Ndërmarrje Tregtare Shërbyese "TINI", MEDVEC, MEDVEC, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër,
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portes me dedektim
në hyrje të objektit të QPS-ës me numër identifikues: 634-24-7640-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portes me dedektim në hyrje të objektit të QPS-ës

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Në objekt të komunes, në QPS dhe në objekt të zjarrefikësive.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë DDP KLINE.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, me së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **21,341.50 €**; njëzet e njëmijë e treqind e katerdhjet e nje euroe e pesdhejt cent.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: *[shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]*

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) *Sigurimi i ekzekutimit*
- (g) *Arbë e biznesit*
- (h) *Vertetimi tatimor*
- (i) *Vertetimi i gjykatës*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj",


"vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10.08.2024
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	HAMEZ KLASNIQI
Pozita:	VENAXHER
Nënshkrimi:	
Data:	30.08.2024
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



PARANASA DHE PARALLOJARIJA PËR BENDORIMET NË DOKUMENTIN E KONTAKTIT

nr. tender	Pratëktimi i përcaktuar	Mësimi	Sasia	Çmimi	Total
A	Punët e ndërtimit dhe riparimit				
1	Zhvendosja dhe bartja e inventarit të zyrave në një vend të caktuar nga AK si dhe atëherë në vende të mëdha për të vend caktuar nga menaxheri i kontratës, pas përfundimit të renovimeve. Dëgjatë tërësi në kushte të vështira të mbuluar me inventar.	m ²	110	0.50 €	55.00 €
2	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve në hollat dhe në hapësirat e breashme, me ngjyrë tërësi me kualitet dhe lloje ngjyre, ngjyra përcaktohet nga organin mbikqyres dhe investitor. Në çmim të furnizimit dhe shërbimeve të tjerë janë të përfshirë me qelq para se të bëhet ngjyrosja.	m ²	420	1.33 €	558.60 €
3	Rregullimi dhe punimi i kulmit, bagazhit për m2. Në çmim të furnizimit, transportit dhe montimit të elementeve të tjerë me atë që shërben (dëgjatë dhe ngjyrosje), në njëjtë të përcaktuar me kushtet dhe elementet tjera përcjellëse.	m ²	10	15.00 €	150.00 €
4	Rregullimi i tek njëjtë sanitare me elemente përcjellëse, gjatë kësaj dhe elementet tjera.	çmimi	30	7.00 €	210.00 €
TOTALI ME TVSH					973.60 €

B	Punët e ndërtimit				
1	Furnizimi, transporti dhe punimi i dyshemes nga betonit me trashësi të 10mm dhe të gjitha elementet përcjellëse që janë: fola, blloqet për shtëpi dhe blloqet për korridor tek derat etj. Para vendosjes së laminatit sipërfaqja duhet të jetë mirë e pastruar. Mbledhja përcaktohet nga organin mbikqyres dhe investitor.	m ²	37	18.00 €	666.00 €
TOTALI ME TVSH					666.00 €

C	Inventari				
1	Furnizimi dhe vendosja e klimes 12 BTU INVERTER	çmimi	1	370.00 €	370.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyshemes me ngjyrosje dhe punime të ndërtimit për të gjitha elementet përcjellëse dhe punime të ndërtimit. Në çmim të furnizimit dhe shërbimeve të tjerë janë të përfshirë me qelq para se të bëhet ngjyrosja. Dëgjatë tërësi në kushte të vështira të mbuluar me inventar. - 6 nivele të ndërthura të detektimit në të gjitha pjesët me transport dhe të përzier. - Alarmi i dritës (LED) në kulmin, tregues me taktues vendosje dhe montazh të montazhit. - Kater çifte të fashës të rrezesve në kushte të vështira për të shpërndarë dritën në kushte të vështira. - 2 bulime 100W i metalëve të fashës dhe metalëve që të zëvendësojë. - Me ripunim të aliazhit prej alumini, deri në 99% për këmbësorët/ingjyrim. - Përdorim teknologjive të kontrollit dhe chat mikroprocesorit, afërsisht anti-nderhyrje. - Secili zone ka 100 nivele ndërtimesh të rregullueshme, në përputhje me kërkesat në rregullime të tjerë të tjerë. - Mund të kalohet dhe frekuenca e alarmit mund të numërohet automatikisht. - Mund të përdoret në mënyrë të pavarur ose dyer siguri të detektimit të ndryshme (dëgjatë me rrezes 60cm) për të përmirësuar nevojat e lëvizjeve nëpërmet kalim. - Funkzioni i mbrojtjes së fashës mund të përdoret për të parandaluar personat e palësuar për të ndryshuar parametrat përkatës. - Struktura e montazhit instalimi i rehte. Diagnostikimi i ndryshimeve identifikim qëndron në detyrat. - Standard: GB 15216-1994. Dëgjatë të detektimit me atë që kalon kushtet teknike të përcaktuara të tjerë të tjerë. - Komiteti Siguria themelore: përmirësimi i kërkesave të programit GB4793 dhe programit që do të ruhet në mënyrë të përcaktuar. - Përdorimi me IP20 (E0529). Siguria personale: Siguria NILEC-0503. - EMC rrezatimi elektromagnetik në përputhje me standardet: përputhje me EN60950, nuk ka dëm për përdoruesit në stimulim kardiale, në grupe shtatzëna, bimë dhe materiale magnetike të regjistruara.	çmimi	1	2,000.00 €	2,000.00 €



- Peshë: rreth 80 kg
- Norma e kalimeve/veprishmerisë: me shumë se 60 miliona / në muajt
 - Madhësia e tunelit: 2030 * 700 * 561mm
 - Dimensio: 2230 * 810 * 561mm
 - Madhësia e jakës: 2280 * 665 * 120mm (Trupi kryesor)
 - Procedur e përbërës: 780 * 480 * 230mm
- Parametret teknike:
- Standard: ISO 15210-1994, Besëkthitë me të cilin dërgohet dhe përdoret
 - Procedurat e detektimit: 100 rregullime ndjekshme mund të kryehen në 15 sekonda me vete.
 - Siguria themelore: përmbajtja e kërkesave të G4713
 - Siguria personale: E Venatur MLC2-0601
 - Norma e kalimeve/veprishmerisë: me shumë se 60 miliona / në muajt
 - Fuqia: 220V AC, 50/60Hz
 - Fuqia: 35VA
 - Temperatura e mjedisit të punës: -10°C - 45°C, r. 95% RH
 - Dimensio i përputhshëm: 2220 mm (lartësi) * 820 mm (gjerësi) * 500 mm (theleshi)
 - Madhësia e paketit: 2000 mm (lartësi) * 700 mm (gjerësi) * 500 mm (theleshi)
 - Peshë përkrahës: rreth 80 kg
 - dhe të gjitha elementet tjera përcjellëse.



TOTAL NET TVSG 2,330,000

D		Punisi dhe montimi i dollapave			
No	Pjesa	Mjete	Sasia	Emri/nci	Qimi
Poi	Furrizimi punimi edhe montimi i dollapave nga drithi me dimensione , Dollapet duhet te jene teje ne shatir ne shatir te parapritura . 3 rrethet e lartit te dollapave jane te				
1	8.20 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	7.320.00 €	7.320.00 €
2	3.95 x 0.65 x 0.40	cepe	1.00	643.00 €	643.00 €
3	0.45 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	175.00 €	175.00 €
4	0.35 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	130.00 €	130.00 €
5	0.45 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	175.00 €	175.00 €
6	0.25 x 3.40 x 0.40	cepe	3.00	98.00 €	196.00 €
7	0.60 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	130.00 €	130.00 €
8	0.95 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	145.00 €	145.00 €
9	0.60 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	145.00 €	145.00 €
10	1.40 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	175.00 €	175.00 €
11	0.60 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	145.00 €	145.00 €
12	1.45 x 0.62 x 0.45	cepe	1.00	168.00 €	168.00 €
13	6.00 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	2.350.00 €	2.350.00 €
14	1.40 x 3.40 x 0.45	cepe	1.00	1.275.00 €	1.275.00 €
15	2.70 x 3.40 x 0.40	cepe	1.00	1.010.00 €	1.010.00 €
TOTALI I PUNIS					10.310.00 €

Wörtyje: Te gyshe dimensioant pors d'heer nja moliet e polsionce exaltatje, oer pui oet te mullen nja por-cleper d'he mull te vortelen veng der d'et ingan shen.

[illegible]

F Punët e rindëimit të banjës					
1	Demolimi i qeramikave ekzistuese në banjo përfshirë dhe pastroimi nënqeramik. Për vendosjen e qeramikave të reja sipërfaqja duhet të jetë më e pastroar. Modeli përcaktohet nga organi mbanësor dhe instalatori.	m ²	3.25	2.00 €	6.50 €
2	Debitokimi si dhe funksionalizimi i WC-se ekzistuese, në ligazim të futes dhe materialit hyrësve të punës kolektorëve dhe elementeve tjera për funksionim. Totali banjos 1.25m ²	komplet	1.00	170.00 €	170.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i një lavaboo dhe një tubshelli i një qarku të shpërndarë në fudat si dhe anëtarëve një bojler të vogël dhe funksionaliteti i tyre si dhe montimi i elementeve përcjellëse sipas, shkasit dhe elementit tjerë.	komplet	1.00	120.00 €	120.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i dyshemeve të banjave dhe enave të banjës me pllakat keramike të tipit "M61" të porcelanizuar të klasit "pure 30x30x0.8 cm vendosja e pllakat me montazh adekuat si dhe me lloga adekuate. Në një bojler të vogël dhe funksionaliteti i tyre si dhe montimi i elementeve përcjellëse sipas, shkasit dhe elementit tjerë. Në dysheme, ndërro ngjyra dhe kualiteti i praxave duhet të caktohet nga ndërmëtyri.	m ²	30.00	20.00 €	600.00 €
TOTALI ME TVSH:				1,046.50 €	

G Instalimet Elektrike					
1	Demolimi i rrjetit elektrik ekzistues, rrjeti i ri duhet të rregullohet, të vendoset në mure, paku është vendosur me kalibër jashtë. Rrjeti elektrik duhet të përmirësohet të zvendoset me kalibër të reja me gjitha elementet perçillet si dhe të vendoset një rreth rryme (norman) i ri. Kapaciteti objekt 150m ² përfshihet të vëzhohet vendi për parafiksim.	m ²	150.00	3.50 €	525.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i trupave 5 ndryesues LEON dhe 100mA dhe në data vende tjera në ngjashmëri me grupin përshkruar furnizimi me kabull adekuate dhe kyçja në rrjetin elektrik për të përdoruesit adekuat si dhe montimi i 10 prizave, siguresave automatikave dhe materialit për montazh dhe montazhi i tyre specifikuar si dhe rregullimi i kabllave instaluar.	komplet	1.00	170.00 €	170.00 €
TOTALI ME TVSH:				695.00 €	

H KAPITULLI I RENDIMET TË DORËT TË KOMUNËS					
1	Punët e shtimit dhe ndërtimit			961.00 €	
2	Punët e dyshemeve			668.00 €	
3	Instalimet Elektrike			2,370.00 €	
4	Punimi dhe montimi i dollzave			10,239.00 €	
TOTALI ME TVSH:				14,238.00 €	

I KAPITULLI I RENDIMET TË PËRSHKËRITËS TË BRENDSHME - ORIENTIMI DORËT TË PËRSHKËRITËS (Komuna Rine)					
1	Punët e ndarjes, shtimit dhe ndërtimit të brendshme			5,113.50 €	
2	Punët e rindëimit të banjës			1,096.50 €	
3	Instalimet Elektrike			795.00 €	
TOTALI ME TVSH:				7,005.00 €	

J KAPITULLI I PËRSHKËRITËS TË BRENDSHME - ORIENTIMI DORËT TË PËRSHKËRITËS (Komuna Rine)					
TOTALI ME TVSH:				7,005.00 €	
TOTALI ME TVSH:				21,341.50 €	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-24-7640-1-2-1/C788

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shpjegimet për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesi e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termin ndërkombëtar tregtar që përbejnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rrezikun që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe, ose detyrim të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluar në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tjetër.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e neni 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e vet për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucioni tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e vet nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk

në kontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihet kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit Kontraktues nuk e lirion Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pëlqim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund t'i japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do t'i lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe sinqeritetin e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrativë që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimi të kontratës, atëherë ai, duke t'u ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do t'i njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tilla brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pëlqim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valinë lirshëm të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhimit ose blerje, transportit, ruajtjes dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatit e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimin e programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të njoftoj vendimin e tij të aproimit të përmendur në Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura në kontratë, programi i tillë i realizimit duhet të konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Në qoftë se nuk ka afat të caktuar, ato do të konsiderohet të aprovuara 30 ditë pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që të ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ri.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manuallet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të jenë në detaje të tilla që do të mundësojë Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manuallet dhe vizatimet do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në formë dhe numra të tilla të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manuallet dhe vizatimet e tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues.

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke in nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifave doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragrykull ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesin do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve

nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbledhen në rastet kur një Furnizuesi i jepet më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta informojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njohim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 16 Vonosat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njohim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilin ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës.

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njohojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhrë administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen, ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depot e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për shtesë në çmimin e kontratës përveç nëse ai e llogarit autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankësë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizuesi përkitazi me këtë ankësë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizuesi, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrim i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkeljet të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në pranim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesin mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jete i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19.1 Furnizuesi do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetin kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrinë kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizuesi do të:

- a) t'i japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihme, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) t'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikimit si duhet të rezultateve të

testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtin kusht dhe rrethana, ose nëse ndonjëri palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshimohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Furnizuesit sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

20.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas fakturës së lëshuar nga Furnizuesi do të bëhen në llogarime bankare të dhënë në Pjesën V. Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi i njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pramueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pramueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizuesi do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasí që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizuesi mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me norme të re-zhritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajt në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkojnë për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Mbrojtja e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pastrave për bartje të rënde në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzimin në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranojnë derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e enkumit me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinacionin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:



Lloji i Garancisë: Sigurim Tenderi

Për

Seria |

10001119234

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

që ka marrë pjesë në tenderin për shërbime të reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike në komunën e reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike

DUKE PASUR PARASYSH QË

Hamzi Krasniqi B.L. - N.T.SH. "TINI"

që ka marrë pjesë në tenderin për shërbime të reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike në komunën e reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portes me dedektim në hyrje të objektit të QPS-ës

të dhënë me numrin e Prokurimit

634-24-7640-1-2-1

që ka marrë pjesë në tenderin për shërbime të reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

1,000.00 €

Një Mije e Euro

që ka marrë pjesë në tenderin për shërbime të reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike

zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospëmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione pëmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;

c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

• Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;

• Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo

• Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej:

1,000.00 €

që ka marrë pjesë në tenderin për shërbime të reparaimit të rrjetit të energjisë elektrike

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

14.08.2024

deri më

12.11.2024

Lëshuar në

Prishtinë

datë

14.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A. / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjia Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Sigurimi për Garanci
Guarantee Insurance



Për **Seria |** 10001124579

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

Adresa e Autoritetit Kontraktues në rastet e rëmbësive të detyrueshme të kontraktuesit

Titulli **Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portës me dedektim në hyrje të objektit të QPS-ës**
Title

Emri i Ofertuesit Name of the Bidder	Hamzi Krasniqi B.L. - N.T.SH. "TINI"	Prej From	30.08.2024
Adresa Address	Medvec	Deri To	29.09.2024
Telefon Telephone	044294539	Shuma e sigurimit Insured sum	2,134.15 €
Numri i personal / biznesit Personal / business number	810586000	Primi Premium	38.41 €
Data e lëshimit Date of issue	30.08.2024	TVSH VAT	6.91 €
Numri i prokurimit Procurement number	634-24-7640-1-2-1	Totali për pagesë Total for payment	45.33 €
Lloji i kontratës Contract type	Garanci Kontrate		

Numri personal / biznesit Personal / business number	000000	Vendi City	KLINË
Adresa Address	ABEDIN REXHA	Telefon Telephone	038/20043715

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nuk ofesoja ka fshehje apo shtramborim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblimi në rast dëmi. Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje me Ligjin nr.05/L-096 si dhe Nenin 9 të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të Bankës Qendrore të Kosovës

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage. The police officer declares that the origin of the funds is in accordance with Law no. 05/L-096 as well as Article 9 of the Regulation on the prevention of money laundering and terrorist financing of the Central Bank of Kosovo

Hysni Gashi





Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Seria |

10001124579

Për

KUVENDI KOMUNAL I KLINES

siç i Autoriteti Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues:

DUKE PASUR PARASYSH QË

Hanzi Krasniqi B.I. - N.T.SH. "TINI"

siç i Operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik":

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, transporti dhe montimi i portes me dedektim në hyrje të objektit të QPS-es

të dhënë me numrin e Prokurimit

634-24-7640-1-2-1

siç i referencës së prokurimit:

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

2,134.15 €

Dy Mije e Një Qind e Tridhjetë e Katër Euro e Pesëmbëdhjetë Cent

siç i referencës së garancisë në numrin e dhënë të garancisë:

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose

- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose

- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumatat brenda limiteve të

2,134.15 €

siç i referencës së garancisë:

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsye ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

30.08.2024

deri më

29.09.2024

Lëshuar në

Prishtinë

datë

30.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË





Polica nr. : 10001124579

Për : KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

Në emër të : Hamzi Krasniqi B.I. - N.T.SH. "TINI"

Titulli i aktivitetit të prokurimit : Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, tansporti dhe montimi i portes me dedektim në hyrje të objektit të QPS-ës

Numri i Prokurimit : 634-24-7640-1-2-1

DERISA kontraktori i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues; DHE NGASE kontraktori obligohet të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar sipas Dosjes së tenderit në rast që Kontraktori dështon të përmbush obligimet sipas marrëveshjes; DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim Kontraktorit këtë siguri:

NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, pa asnjë kusht shtese përveç atyre të cekura më poshtë, deri në një total prej: **2,134.15 € (Dy Mije e Një Qind e Tridhjetë e Katër Euro e Pesëmbëdhjetë Cent)**, në emër të kontraktorit në favor të Autoritetit Kontraktues, si siguri që blerësi do përmbushë të gjitha obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes, në rast që blerësi dështon të përmbushë obligimet e tij. Ne zotohemi të ju paguajmë, shumën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, deri në maksimumin e limitit të cekur më lartë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën ju deklarojeni:

a) që bazuar në gjykimin tuaj, Kontraktori ka dështuar të përmbush obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes.

b) për shumën që bazuar në gjykimin tuaj Autoriteti Kontraktues kërkon të ekzekutohet nga mos përmbushja e obligimeve kontraktuale

Pagesa në shumën e limituar prej: **2,134.15 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit". Kërkesa e juaj duhet të shoqërohet me polisen origjinale dhe të dorëzohet në kopje fizike.

Kjo siguri është e vlefshme prej: 30.08.2024 deri më: 29.09.2024



Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

"PRISIG" SH.A.

Emri i Institucionit finaciuar

Rr.Eduard Lir Ob-2, Lagja Arbëria, Prishtinë

Data: 30.08.2024



Polica nr. : 10001119234

Për : KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të : Hamzi Krasniqi B.I. - N.T.SH. "TINI"

(në vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit : Ndërtimi dhe renovimi i objekteve Komunale, inventarizimi, tansporti dhe montimi i portes me dedektim në hyrje të objektit të QPS-ës

Numri i Prokurimit :634-24-7640-1-2-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE në jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **1,000.00 € (Një Mije e Euro)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesen tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a) Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b) Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tendereve, por para skadimit të periudhes së vlefshmerisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;

c) Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

- Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;

- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo

- Të lidhë kontratë që u pershtatet afateve dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,000.00 €** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkeses tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri është e vlefshme prej: **14.08.2024** deri më: **12.11.2024**



Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

"PRISIG" SH.A.

Emri Institucionit finaciar

Rr.Eduard Lir Ob-2, Lagja Arbëria, Prishtinë

Data: 14.08.2024